

EJONA QOSJA

ORIENTALIZMAT NË VEPRËN LETRARE TË HAKI STËRMILLIT

Orientalizmat janë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe. Duke qenë të tilla, leksikologët shqiptarë në përgjithësi dhe orientologët në veçanti, janë marrë me studimin e tyre duke nxjerrë në dritë rëndësinë e orientalizmave si dhe kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve orientale në gjuhën shqipe.

Një faktor shumë i rëndësishëm që ka ndikuar drejtpërdrejt në futjen e orientalizmave në gjuhën shqipe dhe që ata të jenë pjesë e leksikut, është dhe faktori historik, d.m.th. periudha kur Shqipëria ka qenë nën pushtimin osman. Gjatë 500 viteve, nën zgjedhën turke, krahas ndikimeve të shumta, një ndikim shumë të madh, të përmendur dhe më sipër, pati dhe në leksikun e gjuhës sonë ku u futën shumë fjalë të fushave të ndryshme si në ushtri, në ndërtim, në emërtimet e familjes, në emërtimet e pjesëve të shtëpisë, të trupit, orendive shtëpiake, fjalëve utilitare etj. Këto fjalë u rrënjosën në gjuhën shqipe, duke iu përshtatur strukturave gramatikore dhe fonetike. Ky ndikim u bë i paevitueshëm dhe u reflektua në veprat e shkrimtarëve më në zë.

Por, për studimin e tyre, lindi nevoja e krijimit të një fjalori, të cilin e kemi në gjuhën shqipe, nën titullin “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe” i studiuesit Tahir Dizdari, i botuar në vitin 2005 dhe më vonë i ribotuar. Orientalizmat ose thënë më qartë nga vetë emri, fjalët me burim turk, pers e arab përbëjnë një numër jo të vogël. Të tilla gjejmë që nga Buzuku dhe tek autorë të tjerë, si Noli, Konica, Stërmilli etj. Në trajtimin e kësaj teme, do të shohim të identifikuar dhe studiuara orientalizmat në veprat e Haki Stërmillit, përkatësisht në: Vepra Letrare 1-“Sikur të isha djalë (roman)” dhe “Kalorësi i Skënderbeut (roman)”; Vepra Letrare 2 - Shtigjet e lirisë (ditar); Vepra Letrare 3 e shkruar në prozë me “Skica e Tregime”, “Publicistikë” dhe fragmente nga ditari “Burgu” e fragmente nga romani “Afsh dhe hov zemrash”. Në tri veprat letrare të autorit do të jepen të identifikuar, shpjeguar dhe studiuara orientalizmat, të pasqyruara në formën e një fjalorthi për secilën vepër. Për realizimin e kësaj teme, rol të madh në studimin e fjalëve të burimit turk, arab e pers, ka luajtur “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe”, të cilin e përmendëm më sipër. Në ndërtimin e fjalorthit, është dhënë patjetër

shpjegimi i marrë nga fjalori i sipërpërmendur, si dhe shpjegimi nga “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006) dhe “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), nëse ka. Qëllimi i shpjegimit të orientalizmeve në këtë mënyrë, është bërë për të parë përdorimin e orientalizmeve në shtrirje kohe.

Sot, disa nga orientalizmat nuk kanë më përdorimin e gjerë që kanë pasur. Ata i gjejmë të përdorura në shumë vepra letrare tek autorë të ndryshëm, për të karakterizuar kohën, mjedisin, personazhin a situatën të caktuar.

Falënderoj, mësuesen e gjuhës dhe letërsisë Teuta Qosja për ndihmën e saj të pakushtëzuar në zhvillimin e këtij studimi.

Më poshtë do të jepet e pasqyruar për secilën vepër të autorit një studim i hollësishëm për orientalizmat.

- **Romani “Sikur të isha djalë”**

Romani “Sikur të isha djalë” e shkrimtarit Haki Stërmilli, shkruar në vitet ’30 dhe që rezultoi një *best seller* i asaj kohe, për nga ndërtimi është në formë ditari. Ky roman, së bashku me romanin “Kalorësi i Skënderbeut” bën pjesë në Veprën Letrare 1 të Haki Stërmit.

Ashtu si në gjithë veprat e tjera të tij, të shkruara me gjuhë mjaft të veçantë, edhe kjo vepër është e ndikuar nga kultura orientale, nga vetë tema që trajton, si pasojë ka mjaft orientalizma. Gjejmë mjaft të tilla, që u përkasin fushave të ndryshme, duke filluar nga fjalët që i përkasin drejtpërdrejt fesë myslimane, si: ahiret, Dini, Pejgamber, Qabe etj.; pjesëve të shtëpisë, si: *hatulla*, *minder*, etj., veshje si: *perçe*, *ferexhe*, *nallë* etj. e deri tek emrat e njerëzve, si *Hatixhe*, *Hamit*, *Fahrije*, *Feride*, *Haxhi* etj. Këto fjalë, herë janë të përdorura me kuptim të drejtpërdrejtë e herë me kuptim të figurshëm.

Në roman janë gjetur rreth 70 orientalizma, shpjegimi i të cilave është patjetër në “Fjalorin e orientalizmeve në gjuhën shqipe”, ndërsa në dy fjalorët e gjuhës shqipe, disa fjalë gjenden e disa jo.

Më poshtë do të jepen shembuj për çdo rast:

Ahiret,-i (63) – *m.* Bota tjetër, sipas kuptimit fetar mysliman, jeta e përtejme, e pasosme n’at dynja (katunde të Tiranës), P.sh. I ke të mira për ahiret. Nga *tur. ahret*. Ahire- amshim; bota e përtejme, jeta e përsosur.¹

Bandill,-i (157) – *m.* Djalosh i pashëm e i këndshëm: të ka nëna *bandill*. | *shak.* i dashuri i zemrës. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): 1. djalë i ri e i pashëm. 2. Djalë i ri që do një vajzë.

¹ M. Ndreca, *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*, f. 24.

Bezdi,-a (78) – *f.* Mërzitje, trazim, shqetësim, zugi. P.sh. të vura në bezdi. Nga *tur. bezdirmek*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): *bised*. Mërzi a shqetësim nga dikush që s’e duam ose nga diçka e pakëndshme. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Ndjenja e mërzisë që të vjen nga diçka e pakëndëshme dhe e padëshirueshme.

Jaran,-i (111) – *m.1.* Mik, dashamirës, shok. Në Kosovë jaran përdoret edhe djalë i qenur e shtathedhur. 2. Dashurues, ashik i një vashe, lakmues pas femrash. P.sh. e sillte në shtëpi jaranin e saj përditë. 3. Jaraní-ja Kosovë dhe jug: dashuri, miqësi, afeksion. P.sh. kam jaraní me atë shtëpi, shkojmë e vijmë. Nga *tur. yaran*. Nga persishtja jar. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. I dashuri i dikujt; keq. dashnor. 2. Vjet. Miqësi e ngushtë, shoqëri. 3. Shaka, hokë. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Muhaxhir,-i (151) – *m. mb.* Kudo por pjesërisht ne Veri dhe Kosove përdoret edhe muhaxher. Ai që lë vendin e tij për t’u shpëtuar persekutimeve dhe nëpërkëmbjeve nga zaptuesit, emigrant. Nga *tur.* dhe *ar. muhacir*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): refugjat. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): 1. Ai që largohet nga vendbanimi i tij, kur mbetet pa plang e pa shtëpi dhe që vete në një vend tjetër për të kërkuar strehim e mbrojtje. 2. Sipas kuptimit të emrit. *Fshatarët muhaxhirë*.

- **Romani “Kalorësi i Skënderbeut”,**

Romani “Kalorësi i Skënderbeut”, pjesë e Veprës letrare 1 të Haki Stërmillit, më së shumti një roman me përmbajtje historike por jo vetëm, si gjithë veprat e tjera, ka mjaft fjalë të burimit turk, pers e arab. Pasuria e veprës me orientalizma, ia shton më shumë vlerat dhe hap udhën për ta studiuar më gjerë edhe nga ky aspekt. Kjo punë ka vlerë në fushën e huazimeve në përgjithësi dhe atë të orientalizmeve në veçanti.

Orientalizmat e përdorura në këtë vepër konkretizojnë dhe karakterizojnë kohën kur ndodhin ngjarjet në roman, na çojnë ne në atë kohë. Edhe këtu kemi orientalizmat e përdorura në fushën ushtarake, titujt, si: *bej, pasha, aga, sulltan, bajraktar* që janë tregues të gradave të kohës dhe periudhës osmane, identifikim i kohës, fjalë të ndërtimit, si: *çiflig, çekan*, etj. Gjithashtu gjejmë dhe prapashtesat fjalëformuese *-llëk, -lëk, -llak, -lak*, si: *rrotullak, shkurtalak, pazarllëk, pazarllëqe* etj., prapashtesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në karakterizimin e personazheve, janë tregues të karakterit.

Në këtë roman janë gjetur 73 orientalizma.

Aga,-i (382) – *m.* Në Veri dhe Kosovë me theks parafundor. *Sh. Agallarë.* Në Shqipëri përdoret përgjithësisht për pronar tokash, i cili i mbarështonte këto në mënyrë feudale; pasanikë të pa shkolluar. Në Veri me këtë titull mbiemërzoheshin edhe njerëzit esnafë, i pari i vendit, e katundit, që nuk ishin në rangun e bejlerëve dhe efendilerëve. Në Jug dhe Shqipëri të Mesme me këtë titull emëroheshin më shumë pasanikët e pronarët qytetar e fshatarë. Në rreth të Pukës, aga ka qenë titull fisnikërie i trashëgueshëm për 3-4 familje. Nga *tur. aga* nga folja agmak që do të thotë të rritesh (me u rritë, me u motnue). Më vonë, në Perandorinë Osmane aga janë quajtur ata që s'dinin shkrim e këndim për të merituar titullin efendi. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): 1. *Hist.* Pronar tokash më i vogël se beu; çifligar i pasur, pasanik. 2. *Bised.* keq. ai që mbahet rëndë, sillet vrazhdë e do vetëm të urdhërojë. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Anadollak,-u (243,500) – *m. mb. fig.* I trashë e i pagdhendur. P.sh. mendësi anadollake. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): 1. Banor turk i Azisë së Vogël gjatë Perandorisë Osmane. 2. Si *mb.* njeri, regjim, etj. i prapambetur e i vrazhdë, ai që ndjek zakone të vjetruara e prapanike.

Divan,-i (397) – *m.* Korridor i gjerë në shtëpi; kanape pa mbështetëse. Nga *tur.* < *pers. divan* me kuptimin oborr ose këshillë në Perandorinë Osmane; trup i gjykatës së lartë ushtarake. *Fig.* Me ndejtë në divan: të rish qiri në këmbë.

Dollama,-ja (274) – *f.* Rrobë e gjatë prej cohe a prej shajaku e hapur nga përpara që arin gjer në gju. Nga *tur. dolama* me kuptimin petk i qëmotshtëm cohe i hapur përpara, përsipër të cilit ngjeshet brezi.

Filiz,-i (226) – *m. bot.* Triskull, lastar. Përdoret edhe për moshën e re e të njomë të një kombi. Nga *tur. filiz.* Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): 1. Degë e re, e hollë dhe e drejtë, që del nga trungu a nga degët e një druri, nga rrënja e një bime ose nga kërcelli i saj; lastar i njomë, bisk. Filiz i njomë. Lëshon (nxjerr) filiza. 2. Fidan druri ose bime. Shelgu ndreqet sa është filiz. *fj.u.* 3. *fig.* I ri a e re që ka një të ardhme të mirë; diçka së cilës i përket e ardhmja, diçka e re; fillimi i diçkaje. Filizat e së ardhmes. Filizat e parë të së resë. 4. *fig.* Trashëgimtar i një familjeje; pasardhës i një familjeje; pinjoll. I vetmi filiz që mbeti. 5. *mb. fig.* I drejtë e i gjatë (në trap). E ka shtatin filiz. 6. *mb. fig.* Shumë i ri në moshë, i mitur, i njomë.

Xhind-i (416) – *m.* 1. Sipas besimit fetar, një klasë qëniesh të mbinatyrshme, krijesa të tjera pos njeriut dhe engjëjve të përfutuara nga qeniet shpirtërore të patrup; të padukshme e të paprekshme; hije; shtojzovallë. 2. Xhindi është figurë e përrallave popullore me origjinë orientale. Dalin natën dhe zaptojnë shtëpitë e zadisin njerëzit. Nga *tur. cin* < *ar. xhinn*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): Me të njëjtin shpjegim si më sipër. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Figurë e besimeve dhe e përrallave popullore me prejardhje nga Lindja, e cila përfytyrohet si shpirt i keq, që del natën e që ka fuqi të mbinatyrshme mbi njerëzit e mbi sendet. Xhindet e natës.

- **Vepra letrare 2**

Vepra letrare 2, në të cilën bën pjesë “Shtigjet e lirisë”, ditar, gjejmë të përdorura në penën e autorit, fjalë orientale.

Edhe pse i përket një periudhe më të vonë, e shkruar në vitet ’43-’44, vitet e luftës për çlirim, përsëri orientalizmat janë të pranishme. Ato kanë lënë gjurmë të thella tek autori, edhe pse disa nga këto orientalizma i përdor për të ironizuar personazhe a situata, si: *bashibozuk*, *kalemxhinj*, *kasaphane* etj. Në momente të tjera, i përdor dhe për të treguar forcën e madhe dhe madhështinë e luftës për liri.

Në vepër gjejmë mbi 110 orientalizma, që u përkasin fushave të ndryshme, p.sh. nga feja myslimane, si: *ramazan*, *iftar*, *agjërime* etj., nga emrat e familjes: *baba*, *xhajë*, *hallë* etj. Futja e orientalizmave, pothuajse në çdo fushë të jetës, gjë që dëshmohet dhe në vepër, tregon për ndikimin e madh që kanë sjellë turqit në Shqipëri, duke futur këtu dhe gjuhën.

Aman! (343) – *psthm.* Që shpreh vuajtje e mosdurim; përdoret në kërkesa falje, mëshirë, ndihmë, në lutje, në porosi, etj. të lutem, të qofsha falë. P.sh. Aman, Perëndi! Përdoret dhe për ledhatim: Aman, t’u bëfsha! Në porosi: Aman, mos harro! Nga *tur.* < *ar. aman* (nga pasthirrma. amanin). Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): të lutem; përdoret për të përforcuar shprehjen e pakënaqësisë apo qesëndisë.

Baba,-i (50,291) – *m.* baballarë sh.; në Veri, babë-a. Titulli që u jepet etërve bektashi, i pari i një teqeje. Nga *tur. baba*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. Prindi mashkull kundrejt fëmijëve të vet. 2. Vjehri ose një burrë i moshuar. 3. Themelues a nismëtar i një fushe të dijes, i një veprimtarie, etj. 4. I pari i një teqeje bektashinjsh.

Efendi,-u (265) – *m.* efendilerë sh. Në Elbasan përdoret me rënie të dentalit efeni. Titull që para 45 vitesh i ngjitej emrit të atij që dinte shkrim dhe këndim, të dalluar prej avamit (vegjëlisë dhe popullit), por që nuk bënin pjesë në klasën e aristokracisë, të bejlerëve e të agallarëve të rëndë. Ka qenë kategoria e nëpunësve përgjithësisht, e hoxhallarëve, e dijetarëve të kohës. Ky titull përdorej prapa emrit e para mbiemrit. P.sh. Sylja ef. Hylja. Në Jug e në Shqipëri të Mesme kur i drejtoheshe një hoxhe, mjaftonte të thirrej efendi. Nga *tur. efendi*. Në turqisht ka këto vështirime: zotni, zot, imzot; titull e mbititull në hierarki të ndryshme. Si *mb.* i edukuar, i përmbajtur, i këndueshëm. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): 1. *hist.* Titull nderi që i jepej një njeriu me shkollë në periudhën e pushtimit osman; zotëri. 2. Zotëri. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Kaçmer (178) – *mb.* Përmet: njeri i shëmtuar, me pamje të keqe, stërkeq. Çermenikë, mos u bën kashmer: mos u tall. Malësi e Krujës: me bë kaçmer: më bërë fjalë; shamatë. Nga *tur. kaşmer* “tallës, sojtar”.

Kalemxhi-u (180) *m. sh. Kalemxhinj,-të* Shkrimtaruc; shkrimtar, gazetar që s’interpretonte mendimet e veta. Fjalë e formuar nga kalem-i m. pendë për të shkruar, laps. Nga *tur. < ar. kalem* me shumësin aklam. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): Shkrimtar a gazetar pa vlerë. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

- **Vepra Letrare 3, Pjesa 1**

Pjesa e parë e Veprës Letrare 3, e Haki Stërmillit nga 12 skica e tregime të shkurtra. Në tërësi “Skica e tregime” përmban një numër të konsiderueshëm orientalizmesh ku secili për secilin nga to, do të jepet shpjegimi përkatës, pas përmendjes së fjalës dhe vënies përbri të numrit të faqes ku janë gjetur orientalizmat.

Sipas radhës së dhënë në vepër do të jepen titujt dhe orientalizmat e gjetura në to. “Plaku thinjosh” (f. 7), tregimi i parë, pas një leximi të kujdesshëm ka vetëm një orientalizëm: aga (10). “Lotët e mi” (f. 11) përmban këto orientalizma: ah! (11), florini (11), oda (12). Në tregimin “Dora e djathtë” (14) janë gjetur këto orientalizma: tabut (14), bezbi (15). “Përshëndetje tetës” (18), i katërti në radhë, pas leximit të kujdesshëm nuk ka asnjë orientalizëm. “Dy shokët” (21) ka këto orientalizma: sedra (24), shesh (24), potere (24), udhë (24), bilbil (25). Tregimi i gjashtë, “Lulja krutane” (27), përmban këto orientalizma: floringjtë (28), bilbil (30), pajë (30), nopran (31). “Flokarta” (34), ka këto

orientalizma: kollan (34), kulla (36), duhan (36), floringjtë (38). Në “Të fejuemit” (39) janë gjetur këto orientalizma: gajtane (39), bilbil (39), shesh (42), sedër (42), pazarllëk (43), hasëm (44), kafe (45), potere (46). “Lironi rrugën” (48) përmban këto orientalizma: sedër (48), kullë (49), odë (49), xhezme (49), pishtar (49), kafe (50), raki (50), sofër (50), bajame (50), çifteli (51), curle (51). “Zemra të dënueme” ka këto orientalizma: çekani (57), kafe (59). Tregimi “Fatushja” ka këto orientalizma: sedër (61), flori (62), shishe (63). I fundit “Ke vorri i Jorgjit: hall (64).

Siç shihet, edhe në “Skica dhe tregime” orientalizmat i përkasin fushave të ndryshme, të përdorura në kontekste të ndryshme.

Gajtan,-i. Njëthurje e trashë prej mëndafshi, prej leshi a prej pambuku që vihet anëve të rrobës për stoli a për të mos i dalë thekët. *FGjSh*. Spikth i rrumbullakët e i punuar me fije mëndafshi, pambuku a ari, që përdoret në qëndisje, sidomos të veshjes kombëtare. Nga *tur.kaytan*, nga *ar.gajtan*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. Shirit ose gjalmë i përdredhur anës veshjeve për stoli a për të mos dalë thekët; fill i trashë i përdredhur ari, argjendi a mëndafshi, me të cilën qëndisnin a stolisnin veshjet kombëtare. 2. *mb.poet*. I hollë e i drejtë (zakonisht për vetullat). Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Hall,-i – *m*. Përfshihet në gjithë fjalorët; përdoret në mbarë truallin shqiptar dhe ashtu si shumë huazime të tjera turke është bërë pronë e gjuhës tonë, me këta vështirime: gjendje, kusht, nevojë, zënie ngushtë, brengë, vështirësi. P.sh. nuk ka njeri pa halle. Nga *tur. hall*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. Gjendje e vështirë kur njeriu vuan nga mungesa e diçkaje etj.; brengë; nevojë e madhe; telash, e keqe. 2. Zgjidhje, rrugëdalje. P.sh. si do të vejë halli.

Hasëm,-i – *m*. Armik; në përgjithësi armik më të cilin jemi në gjak, gjakës; kundërshtar, dashakeq; sin. dushman. Kjo fjalë edhe sot e kësaj dite, është fjalë e përdorimit të gjerë në truallin shqiptar. Nga *tur. hasim* < *ar. khasm*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. Ai që është në hasmëri a në gjak me dikë, gjakës. 2. Armik. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Shishe,-ja – *f*. 1. Enë me grykë të ngushtë për të mbajtur ujë, pije, vaj, barëra, etj. 2. Në Jug: poç i kandilit; shishe llampe. 3. Shishkë-a f., shishëzë-a f., shishe e vogël për levantë. Nga *tur.* < *pers.shishe*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): Enë e vogël qelqi për lëngje, zakonisht e gjatë dhe me grykë të ngushtë. Kjo fjalë gjen

shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Enë prej qelqi, zakonisht e gjatë dhe me grykë të ngushtë, që shërben për të mbajtur lëngje.

Tabut,-i – m. Arkë e hapur përsipër për të bartur të vdekurit; vig, arkivol. Në të folurën e Gjirokastrës dhe në rrethe bëhet ky dallim: për të njëjtin mjet kur ka të bëjë me të vdekurin mysliman thuhet tabut, për të vdekurin e krishterë thuhet vigjë. Nga tur. < ar. tabut. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): arkivol. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

- **Vepra Letrare 3, Pjesa 2**

Në pjesën e dytë të *Veprës Letrare 3*, do të gjejmë publicistikë të botuar nga autori në organe të ndryshme të shtypit të asaj kohe. Disa nga këto organe të shtypit të shkruar janë: “Shqipëtar i Amerikës”, “Dajti”, “Liria kombëtare”, Nëntori” etj. Shkrimet e botuara i përkasin viteve ‘30-’40 dhe, me qenë se këto janë shkruar për t’u botuar, vihet re dhe prirja e autorit për të mos përdorur orientalizma dhe ka qenë në një farë mënyrë fanatik në përdorimin e gjuhës letrare shqipe.

Në këtë pjesë, nën titullin *Publicistikë*, do të gjejmë 32 shkrime, të shkruara nga autori ose për autorin, të cilat kanë prekur tema të ndryshme që shqetësonin popullin e kohës. Në disa nga këto shkrime, pas një leximi të kujdesshëm, nuk kam gjetur asnjë orientalizëm. Të tilla janë: “Të fala qytetit tim prej që largu” (66), “Vdekja e Avni Rustemit” (77), “Lajme telegrafike” (78), “Bashkimi dhe zgjedhjet (84)”, “Disa vërejtje për telegrafinë tonë” (123), “Prapë për ortografinë tonë” (128), “Një përgjigje” (74), “Për gjuhën tonë” (130) dhe “Kongresi i Dytë Botëror Antiimperialist proteston pranë qeverisë shqiptare për arrestimin e Haki Stërmillit” (174). Në shkrimet e tjera, tek disa më pak e tek disa më shumë gjejmë orientalizma, të përdorura në fusha të ndryshme. Ato janë:

Trimnia e grues shqiptare (71): llagam (71), xhep (72).

Së ndershmes drejtorisë së gazetës “Dajti” (79): shesh (80).

Trupi i të ndjerit Avni përpara prindërve (81): liman (82)

Bashkimtarëve (87): hamallë (87), turk (88), bej (88), katil (89).

Festa e flamurit (90): sulltan (90), tallaz (90), vakufe (92), karvan (92), efendi (92), floringjtë (92), toptan (93).

Kulmi i tradhtisë dhe rreziqet e luftës (95): qull (96), dajak (96), katil (96), barut (98), bej (99), oxhak (99).

Mbi vorr të një martiri (100): xhelat (100), katil (100), potere (103).

Nji propozim (104): xhelat (104), bej (105), bejlerë (106).

Kriza ekonomike dhe penetracioni italian në Shqipëri (107): bile (107), duhan (107), flori (108), grosh (108), tezga (108), qira (109), bej (109), bejlerë (109), xha (109), dallaukë (109), potere (110), berberë (110), berberka (110), katil (110).

Sepse (113): çarçaf (114), jorgani (114), merak (115), bile (115), borxh (115), xhep (115), sedër (116).

Shqipëria dikur, dje, sot dhe nesër: çerek (118), çelik (119), sedër (120).

Kryengritja e përgjithshme e Dibrës (133): tabakhania (133), xhelat (134), bej (135), lira (137), flori (137), gajret (137), huxhum (137), xhepane (137), hyqmet (137).

Dibra (139): pazari (139), lixha (139), pashallarë (141), pasha (141), beu (141), sulltanë (141).

Viktor Hygo (144): harbut (146).

Sami Frashëri (148): bej (148), sabah (149), sulltan (149).

Rexhep pashë Mati (153): pashë (153), pajë (153), hoxhë (153), oxhak (153), mulla (153), sulltan (154).

Partizani shtatëdhjetepesëvjeçar (156): bajraktarëve (157), sedra (157).

Ndre Mjeda – poet patriot (160): sulltani (160), otomane (161), osmanllinjë (162), bajraktarëve (162), bilbil (163), pashë (163).

Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare – qendër e madhe pelegrinazhi (): baballarë (168), amanet (168).

Protestë telegrafike Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në Beligrad për dorëzimin e Haki Stërmillit në duart gjakësore të Ahmet Zogut (170): xhelat (170).

Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë (171): xhelat (171).

Bashkëpunimi i diktatorëve jugosllavë dhe shqiptarë (172): teslim (173), bejlerëve (173).

Gazeta “Liria kombëtare” demaskon satrapin Zog për mbajtjen në burg të Haki Stërmillit (175): xhelat (175), kollaj (175).

Berber,-i – *m.* Ai që ushtron zejen e rruajtjes dhe të qethjes; rrues. Në Tiranë shqiptohet dhe byrberë. Nga *tur. berber*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): Ai që ka për mjeshtëri të qethë flokët e të rruajë, floktar. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Dallkauk,-u – *m.,mb.* Ai që me qëllim përfitimi bën hipokrizi, duke nëpërkëmbur personalitetin e dinjitetin e vet; lajkatar i ndyrë që u kreh bishtin të tjerëve, njeri me dy faqe. Me të njëjtat vështrime si në shqip, nga *tur. dalkauk*.

Duhan,-i *m.* Bima industriale e njohur, me shije të vrazhdë e të hidhur, tymosen e pihen gjethet e saj te thara, që përmbajnë nikotinë. Është e prejdardhur nga Amerika Jugore dhe ka një numër të madh variantesh të nxjerra nga kultivimi. P.sh. të pish duhan. *Duhanore-ja*: tokë e destinuar për tu mbjellë duhan. Duhantore-ja: neologjizëm, për dyqanin ku shiten cigare e duhan. Nga *tur.duhan*, nga *ar.dukan*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): bimë njëvjeçare me kërcell të lartë e me gjethe të gjera që përmbajnë nikotinë; gjethet e kësaj bime, që të thara e zakonisht të grira hollë bëhen cigare e futen në llullë dhe ndizen për t'u thithur tymin. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Llagam,-i – *m.* Në Jug përdoret llagëm-i. 1. Vijë nëntokësore e mbuluar përsipër, që hapet për të kulluar ujërat; kanal. 2. Shteg a vrimë që hapet nën dhe mbushet me eksploziv për të çarë shkëmbinj, etj. Nga *tur. lagim* < *pers. lāgām*.

Llixhë,-a – *f.* Burim natyral ujërash minerale të nxehtë për të bërë banjë dhe kura. Të përmendura: llixhat e Elbasanit, llixhat e Peshkopisë, llixhat e Leskovikut. Nga *tur. ilicá*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): Qendër kurimi me ujë termale. fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Qendër me burime ujërash termale, ku bëjnë banjë të sëmurët për të mjekuar disa sëmundje. Llixha e Elbasanit (e Peshkopisë).

Qull,-i *m.* Miell misri i zier, i cili pasi trashet pak përvëlohet me gjalpë e me vaj skrop. Lëng i pulës a i lepurit i trashur me miell, që kur hidhet më pjatë, i rreshtohen përsipër thelat. *khs. tur. çullama*, u thuhet atyre gjellëve që mbulohen me qull përsipër ose për ato gjellë të brumëta sipër të cilave rrethohen thelat e mishit. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (2006): 1. Gatesë me miell të skuqur, me ujë dhe me yndyrë, që zihet deri sa bëhet lëng i trashë; brumë i hollë perimesh; qull molle. 2. Lëng i trashë i diçkaje; qull gëlqereje. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): 1. Gatesë e përgatitur me miell të skuqur e të zier me ujë a me qumësht. Qull i trashë (i hollë). 2. Ushqim për fëmijët e vegjël, i përgatitur zakonisht me miell orizi të zier me ujë a me qumësht dhe me sheqer; paluze. 3. Perime a pemë të grira ose të ziera e të shtypura si brumë i lëngët. Qull mollësh. 4. Diçka si brumë i ujshëm ose si lëng i trashë. Qull gëlqereje. 5. përd. mb. I lëngshëm (për gjellët që duhet të jenë pa lëng); fare i papjekur e i pa kulluar, i qullët (për bukën, byrekun etj.). Është bërë pilafi qull. Ka mbetur buka (byreku) qull. 6. përd.

mb. Shumë i lagur, shumë i njomur, ujë. U bë qull u lag shumë, u bë ujë. U bë qull në djersë. I ka rrobat qull.

- **Vepra Letrare 3, Pjesa 3**

Pjesa e tretë dhe e fundit e *Veprës Letrare 3* përfshin fragmente të ditarit “Burgu” dhe fragmente të romanit “Afsh dhe hov zemrash”. Ashtu si në veprat e tjera, edhe këtu në gjuhën e përdorur nga autori gjejmë mjaft orientalizma.

Në fragmentet e ditarit “Burgu”, orientalizmat e përdorura, më së shumti i përkasin ligjërimin bisedor, gjë që e bën dhe autorin pjesë të mjedisit patriarkal e oriental, pikërisht mjedisin ku është, në burg. Fjalët orientale që përdor autori tregojnë mjedisin e rëndomtë, ironizimin e atyre që janë në hierarkinë shtetërore të kohës. Në këto fragmente ditarit të mbajtur nga autori, përveç orientalizmave kemi dhe toponime me burim turk, si Tabakhanë, Namazgjah, si dhe mjaft antroponime, si Halit, Qerime, Harxhi etj., prapashtesa fjalëformuese -llak, -llëk (kapadaillëk, rrotullak, etj.).

Fragmentet e romanit “Afsh dhe hov zemrash”, është në një numër shumë të vogël faqesh dhe si pasojë dhe orientalizmat janë në numër të kufizuar. Edhe pse të pakta në numër, si në veprat e tjera, kanë funksione të ndryshme dhe i përkasin fushave të ndryshme gjithashtu.

Anadollak,-e (286) *mb.* fig. I trashë e i pagdhendur. P.sh. mendësi anadollake. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): 1. Banor turk i Azisë së Vogël gjatë Perandorisë Osmane. 2. Si *mb.* njeri, regjim, etj. i prapambetur e i vrazhdë, ai që ndjek zakone të vjetruara e prapanike.

Sihariq,-i (222) – *m.* Sipas fjalorit Weigant ADË 77 tregohet si fjalë turke por thuhet se nuk është fjalë turke dhe as me prejardhje prej andejmi. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): lajm i mirë dhe i gëzuar. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980): Lajm i mirë e i gëzuar për dikë ose për ndonjë ngjarje të madhe me rëndësi shoqërore.

Tagar,-i (192) – *m.* 1. Masë drithi 44 okëshe. 2. Devoll: enë që ka fundin prej lëkure me të cilën bartet drithë. Zakonisht është në një masë të caktuar = 0.5 shinik dhe vlen si matëse drithi. 3. Tagare-ja f. Masë e drunjtë 10 kg për drithë e ullinj që përdoret në fshatrat e Tiranës. 4. Në fjalorthin “Këngë popullore lirike” jepet me kuptimin sahan. Në *tur. tagar* ka kuptimin: torbë lëkure në të cilën barinjtë dhe udhëtarët fusin ushqimet e tyre; masë drithi që ndryshon sipas vendeve në përmbajtje të sasisë.

Tallaz,-i (180,310) – *m.* 1. Dallgët e detit, tundullimë. 2. Hov, vrull; mos e merr punën me tallaz. 3. Rreze, rrënjim; mëndafsh, pëlhurë me tallaze. Nga tur. talaz. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): Me të njëjtin shpjegim si më poshtë. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): 1. Dallgë deti, valë e madhe që vjen me forcë e vrull. Tallazet e detit. 2. fig. Hov që merr dikush, vrull për diçka. 3. kryes. fig. Valë e madhe brengje e shqetësim; vështirësi e madhe, dallgë. Tallazet e jetës (e luftës). 4. Ndriçim i valëzuar që jep faqja e diçkaje, ndriçim valë-valë, rreze.

Xhami,-ja (330) – *f.* Ndërtesë, destinuar nga myslimanët për ushtrimin e kultit. Karakteristikë dhe gjithkund e përbashkët është topografia me arkitekturën e saj: një oborr i rrethuar me parrmakë, në mes të saj një pus e çezme, në një skaj currilat për të marrë abdes. Një safallek i gjerë që bën pjesë nën strehën e tempullit e në hyrje të tij. Qilima, sixhade dhe të shtruar në dyshe, e ndonjë sahat i madh, janë stolitë e brendshme. Përreth mureve ka duana të futura në kornizë, me përmbajtje ajetesh dhe hazdisesh të shenjta. Nuk mungojnë dritat e llambadarët. Nga tur. < ar. *xhami*, nga xham'a që do të thotë të mbledhësh, të bashkosh. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): Ndërtesë ku bëhen shërbesat sipas riteve fetare të myslimanëve, faltore e myslimanëve (në vendet ku vepron feja islame). Xhami e vjetër. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

Xhep,-i (182,345) – *m.* 1. Srajcëz, qesëz, goja e së cilës qepet në një të hapur të petkut, që vlen për të futur gjëra të vogla që na nevojiten orë e çast. 2. Të hollat që posedon njeriu, kuleta. 3. *fig.* Gjithë ditë me duar në xhepa: rri pa bërë asnjë punë. Nga tur. *cep* < ar. *xhejb*. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006): 1. Pjesë e një rrobe në trajtën e një qeseje të qepur nga brenda ose si copë përsipër, e cila shërben për të vënë sendet që mbajmë me vete ose për zbukurim. 2. Ndarje e vogël e veçantë, e qepur nga tri anë në një çantë, në një valixhe etj. Xhepi i çantës (i valixhes, i kuletës). 3. Përdoret në tog me një emër tjetër për të shënuar diçka të vogël a të paktë, që mund të mbahet me vete. Orë (sahat) xhepi. Shami xhepi. Bllok xhepi. Fjalor xhepi fjalor shumë i vogël. 4. *spec.* E thelluar a gropë në një send, në tokë etj., në të cilën mblidhet, grumbullohet një lëndë a futet diçka. Xhep nafte (gazi). *min.* Xhepat e pistës. Xhepat e bilardos gropat anës tryezës së bilardos, ku futen bilat. Xhepi i plagës qeskë me qelb në një plagë. Xhepat e malit. Xhepat e syve qeska nën sy. Hapin xhepa. 5. *usht.* Depërtim i thellë i një pale

ndërluftuese në një pjesë të ngushtë prapa vijës mbrojtëse të kundërshtarit. Krijuan një xhep. E asgjësuan (e rrafshuan) xhepin. 6. *fig. bised*. Të hollat, paratë që ka një njeri; të ardhurat, pasuria e dikujt. Kjo fjalë gjen shpjegim dhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980): Me të njëjtin shpjegim si më sipër.

PËRFUNDIME

Për sa u trajtuam më në këtë kumtim, mund të përfundojmë se orientalizmat janë të pranishme në leksikun e gjuhës, e si rrjedhojë përdoren dhe në letërsinë artistike. Faktorët historikë, politikë, kulturorë e socialë kanë bërë që sot orientalizmat të kenë një përdorim më të cunguar. Gjithashtu, në letërsinë artistike përdoren në kontekste të ndryshme. Falë tyre, shkrimtari Haki Stërmilli tipizon personazhe, situata kohë a mjedise të ndryshme.

Orientalizmat e gjetura në secilën nga veprat e tij, kanë karakteristika të veçanta, që u përmendën dhe në hyrjen e çdo vepre. Kishte fjalë shpjegimi i të cilave gjendej vetëm në “*Fjalorin e orientalizmave në gjuhën shqipe*”, si p.sh.: *ahiret, hazret, hoka, tagar, tugë* etj., u gjetën fjalë shpjegimi i të cilave gjendej në një nga fjalorët e gjuhës shqipe, përveç atij të orientalizmave, si: *bandill, bajraktarë, anadollak*, etj. ashtu siç janë gjetur fjalë që kishin shpjegim në tre fjalorët më të cilët kam punuar, si: *hajde, hoxhë, shyqyr, sulltan* etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur emrat e vendeve (Tabakhane, Namazgjah) dhe emrat e njerëzve (Fahrije, Elmaz, Faik) që janë me burim turk, arab e pers. Gjithashtu dhe prapashtesat fjalëformuese -llëk, -lëk, -lak, -llak janë të pranishme në formimin e fjalëve me burim oriental ose jo.

Orientalizmat kanë qenë pjesë e pandashme e gjuhës dhe e ligjëritimit shqip. Sado larg në kohë, ato i gjejmë në përdorim, herë me kuptim të drejtpërdrejtë e herë me funksion artistik, si mjet stilistik. Tek autori Haki Stërmilli, i gjejmë të përdorura në të dyja këto funksione. Kjo e bën atë të veçantë për gjuhën e përdorur dhe për stilin origjinal që e karakterizon.

